



K.Dh.Sh.II.nr.632/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit H.P. B.I me emër tregtar N.T.P.T “Renesanca” me seli në fsh. Banjë e Pejës, komuna Istog, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.A., avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Ministria e Infrastrukturës me seli në Prishtinë, sipas kërkesës nga neni 68 i Ligjit për Konfliktet Administrative dhe kompensimit të dëmit material, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Administrativ, KA.nr.44/22, të datës 08.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **Aprovohet** si e bazuar ankesa e të paditurit Ministria e Infrastrukturës më seli në Prishtinë.
- II. **Prishet** Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Administrativ, KA.nr.44/22, të datës 08.12.2022, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Administrativ, KA.nr.44/22, të datës 08.12.2022, nën pikën I të Dispozitivit Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit H.P. B.I me emër tregtar N.T.P.T “Renesanca”. Në pikën II. Obligohet i padituri Ministria e Infrastrukturës që paditësit H.P. B.I me emër tregtar N.T.P.T “Renesanca”, për shkak të revokimit të rendit të udhëtimit nr.44/03/13 me nisje në ora 13:45 dhe kthim 15:30 në relacionin Pejë – Gurakoc – Istog – Pejë, t’ia kompensoj dëmin në emër të fitimit të humbur në shumën prej 36,195.00€ (tridhjetë e gashtë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë euro) me kamat ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë, datë 27.12.2018, e deri në përmbushjen përfundimtare, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i padituri Ministria e Infrastrukturës për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet Aktgjykimi KA.nr.44/22 e datës 08.12.2022, të refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të

nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

- Ankesa është e bazuar.

Me Aktgjykimin A.nr. 1641/2013 të datës 06.10.2016 Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit NTPT “Renesansa” dhe ka anuluar vendimin nr. 3187 të datës 01.11.2013 i nxjerrë nga i padituri dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek i padituri me arsyetimin se vendimi i kontestues është juridikisht i paqartë dhe kundërtihënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Paditësi me datë 23.12.2016 i është drejtuar të paditurit me kërkesë për ri-shqyrtimin e lëndës sipas aktgjykimit të lartcekur por i padituri nuk ka nxjerrë vendim sipas aktgjykimit të datës 06.10.2016. Për shkak të heshtjes administrativ paditësi përsëri kishte parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Me Aktgjykimin A.nr. 91/2017 të datës 31.10.2018 Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka detyruar të paditurin që në afat prej 30 ditëve të nxjerrë aktin administrativ në rivendosje sipas kërkesës së paditësit të datës 23.12.2016. I padituri përsëri nuk ka vepruar sipas Aktgjykimin A.nr. 91/2017 të datës 31.10.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative pasi që nuk ka nxjerrë vendimin brenda afatit ligjor, për çfarë paditësi me datë 10.12.2018 ka paraqitur kërkesën e përsëritur për vendosje ndërsa me datë 27.12.2018 ushtruar padi për shkak të heshtjes nga i padituri.

Gjykata e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, me arsyetimin se “Gjykata i vlerësoi si të bazuara pretendimet e paditësit sepse e paditura nuk ka vepruar sipas dy aktgjykimeve (Aktgjykimin A.nr. 1641/2013 të datës 06.10.2016 dhe Aktgjykimin A.nr. 91/2017 të datës 31.10.2018) të nxjerra nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me të cilat fillimisht është anuluar nr. 3187 të datës 01.11.2013, ndërsa me aktgjykimin pasues është obliguar i padituri që të nxjerrë vendim brenda afatit prej 30 ditëve, por që i padituri përsëri nuk ka vepruar sipas aktgjykimit të gjykatës. Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se i padituri ka vepruar në kundërshtim me nenin 65 të LKA-së i cili përcakton se: “Kur gjykata e anulon aktin, kundër të cilit ka filluar konflikti administrativ, lënda kthehet në gjendjen në të cilin ishte para se të ishte nxjerrë akti i anuluar. Nëse sipas karakterit të çështjes, që ka qenë objekt i konfliktit, duhet që, në vend të aktit të anuluar administrativ, të nxirret një tjetër, organi kompetent ka për detyrë ta nxjerrë 6 / 7 pa shtyrje, jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dërgimit të aktgjykimit. Organi kompetent, në këtë rast, është i obliguar nga pikëpamja juridike e gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën.” Kjo pasi që, pas Aktgjykimit A.nr. 1641/2013 të datës 06.10.2016 dhe Aktgjykimin A.nr. 91/2017 të datës 31.10.2018 nuk kishte nxjerrë fare aktin administrativ sipas pikëpamjes juridike të gjykatës të dhënë në aktgjykimet e saj. Gjykata po ashtu vlerësoi Vendimin nr. 109 datë 04.01.2019 dhe

Vendimin nr. 75 i datës 01.03.2019 të nxjerrë nga Ministria e Infrastrukturës por duke qenë se në këtë çështje ishin paraqitur dy vendime identike me datë dhe numër protokollit të ndryshme dhe të cilat vendime asnjëherë nuk i ishin dorëzuar paditësit në procedurë administrative, gjykata nuk mundi të ju falë besimin të njëjtave. Duke qenë se vendimi i vetëm në procedurë administrative (vendimi nr. 3187 i datës 01.11.2013) është anuluar me Aktgjykimin A.nr. 1641/2013 të datës 06.10.2016, ndërsa pas këtij vendimi, i padituri nuk ka nxjerrë vendim tjetër në procedurë administrative dhe duke qenë se përfaqësuesi i paditësit kishte kërkuar vetëm kompensimin e dëmit pasi që nuk kishte akt tjetër administrativ për të goditur, gjykata në kuptim të nenit 44 dhe 46 par. 5 të LKA vendosi për kompensimin e dëmit që paditësi ka pësuar për shkak të revokimit të rendit të udhëtimit nr. 44/03/13 me nisje në ora 13:45 dhe kthim në 15:30 në relacionin Pejë – Gurakoc – Istog – Gurakoc – Pejë, përkatësisht vendosi për fitimin e munguar të paditësit për periudhën nga revokimi i rendit të udhëtimit e deri në hartimin e ekspertizës financiare.

Kolegji i kësaj gjykate duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, duke e shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, vendimet e organit të paditur Ministria e Infrastrukturës, si dhe shkresat e tjera të lëndës sipas pretendimeve në ankesë, gjen se aktgjykimi i goditur është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) dhe nga neni 183 e 184 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, se është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, dhe si i tillë është jo i plotë në vërtetimin e gjendjes faktike, për çka në mënyrë të bazuar theksohet në ankesë.

Kolegji i kësaj Gjykate, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë nuk mund t'i përkrahë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se gjykata e shkallës së parë në rastin konkret është dashur që të veprojë si në vështrim të nenit 36 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktin Administrativ, me të cilin përcaktohet se *“Nëse organi gjatë kohës së procedurës gjyqësore nxjerr aktin tjetër me të cilin revokohet ose shfuqizohet akti administrativ kundër të cilit është ngritur konflikti administrativ, si dhe në rastin nga neni 29 i këtij ligji nxjerr më vonë aktin administrativ, ky organ, përpos paditësit, do ta njoftojë edhe gjykatën. 2. Në këtë rast gjykata do ta ftojë paditësin që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh të deklarojë nëse me aktin administrativ të nxjerrë në afatin e mëvonshëm: 2.1. është i kënaqur; 2.2. nuk heq dorë nga padia; 2.3. pjesërisht heq dorë nga padia; 2.4. ai/ajo padinë e zgjeron edhe në aktin tjetër. 8 3. Nëse paditësi deklaron se me aktin e nxjerr në afatin e mëvonshëm është i kënaqur apo nëse nuk e jep deklaratën brenda afatit nga paragrafi 2. i këtij neni , gjykata do të nxjerrë vendimin mbi pezullimin e procedurës. 4. Nëse paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është ai/ajo i kënaqur, gjykata do ta vazhdojë procedurën.”* Prandaj, në rastin konkret përderisa ekziston një akt administrativ i nxjerr nga ana e organit administrativ, fillimisht gjykata duhet ta shqyrtojë të njëjtin në bazë të dispozitave të lartcekura, ashtu që fillimisht gjykata të kërkojë nga pala e paditur dëshmi për dorëzimin e vendimit palës paditëse, pastaj të kërkojë nga pala paditëse që të deklarojë nëse me aktin administrativ të nxjerrë në afatin e mëvonshëm është i kënaqur, nuk heq dorë nga padia, pjesërisht heq dorë nga padia, ai/ajo padinë e zgjeron edhe në aktin tjetër. Nëse paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është i kënaqur, gjykata do ta vazhdojë procedurën, ngase organi i paditur gjatë zhvillimit të gjykimit në gjykatën e shkallës së parë ka nxjerrë akt

me të cilin ka vendosur për çështjen e këtij konflikti administrativ duke vepruar konform aktgjykimit A.nr.19/2017 të datës 31.10.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë– Departamenti për Çështje Administrative. Andaj, në kuptim të nenit të lartcekur kur paditësi deklaroi se me aktin e administrativ nuk është i kënaqur, apo se dëshiron të vazhdojë gjykimin, gjykimi vazhdon si në vështrim të nenit 36 të LKA-së, dhe në këtë rast akti i administrativ, automatikisht përfshihet në gjykim, që do të thotë se akti administrativ gjatë procedurës gjyqësore si në këtë rast, automatikisht përfshihet në procedurën në vazhdim, që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në mënyrën e tillë. Kolegji vlerëson se në situatën e tillë juridike se si ka vepruar gjykata e shkallës së parë ka krijuar paqartësi se tani me kemi dy vendime në fuqi një të organit administrativ i cili nuk është anuluar nga gjykata, dhe aktgjykimin e ankimuar. Kolegji nuk pajtohet me qëndrimin juridik të gjykatës e shkallës së parë se për shkak të dy vendimeve me data ndryshe gjykata nuk ja falë besimin, për arsye se akti administrativ në procedure administrative nuk është provë e zakonshme për të vlerësuar se ia falë apo nuk ja falë besimin gjykata po është akti administrativ në baze të cilit vendoset për të drejta e subjekteve në procedure në baze të dispozitave të LPP, e për të cilën gjykata bënë vlerësimin e ligjshmërisë së aktit administrativ përkatësisht ushtron një kontroll gjyqësor përmes vlerësimit të tij. Gjithashtu shterja e mjeteve juridike në procedure administrative dhe inicimi i konfliktit administrativ ndaj akteve administrative nga subjektet në procedurë vlerësohet edhe lejueshmëria e padisë. Gjykata shkallës së parë nuk ka sqaruar faktin se a ka kërkuar nga e paditura të deklarohet se a janë dorëzuar vendimet 01/109 dhe 01/75 palës së paditëse, e nëse janë dorëzuar atëherë a është ushtruar mjeteve të ankese nga paditësi, ndërsa nëse nuk është pranuar asnjë vendim nga subjekti në procedure-paditësi pas vendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.91/2017 dt. 31.10.2018, atëherë subjekti në procedure a ka paraqitur kërkesë tek e paditura sipas neni 68 të Ligjit për Konfliktet Administrative, pas aktgjykimit të lartcekur A.nr.91/2017 dt. 31.10.2018.

Neni 68 i LKA-se Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerr menjëherë, e jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh, aktin e ri administrativ ose aktin në zbatimin e aktgjykimit të nxjerrë në bazë të paragrafit 4. të nenit 46 të këtij ligji, pala mund të kërkojë, me parashtrësë të veçantë, nxjerrjen e aktit të tillë. Nëse organi kompetent nuk e nxjerr aktin brenda shtatë (7) ditësh nga kjo kërkesë, pala mund të kërkojë nxjerrjen e aktit të tillë nga gjykata që ka nxjerrë aktgjykimin..

Prandaj, për këto arsye, në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të mënjanojë të metat e lartcekura, të analizojë dhe me kujdes të bëjë vlerësimin e të gjitha provave lidhur me pretendimet e paditëses, dhe pas shqyrtimit dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të drejtë të së drejtës materiale, ka mundësi të bëjë aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm në kuptim të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative. Për arsyet e lartcekura kjo gjykatë tani për tani nuk mund të pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm një aktgjykim të tillë, ngase është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) lidhur me nenin 183 të LPK-së. Në ri procedure, gjykata e shkallës së parë në seancë gjyqësore duhet që të veprojë si në vështrim të dispozitave të lartcekura dhe varësisht nga kjo vendimi i paditësit për kundërshtimin ose jo të aktit administrativ, të bëjë aktgjykim të drejtë dhe të bazuar në dispozita ligjore.

Meqë me këtë aktgjykim, nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, dhe se i njëjti është i përfshirë edhe me shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, kolegji i kësaj gjykate vendosi që aktgjykimin e ankimuar ta anulojë si jo të drejtë dhe jo ligjor, ashtu që çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Nga të lartë cekurat e në kuptim të nenit 43.2 dhe 49 të LKA-së, dhe nenit 195 par. 1 pika c) i zbatueshëm përmes nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.632/23, me datë 08.02.2024

**Kryetar i kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi**